

VENDIM
Nr. 435, datë 3.6.2020

PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT, PARAUNIVERSITAR, TË ARSIMIT BAZË DHE TË ARSIMIT TË MESËM TË LARTË “WOODROW WILSON INTERNATIONAL”, KU MËSIMI ZHVILLOHET EDHE NË GJUHËN ANGLEZE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e lejes shoqatës “*Woodrow Wilson*” për hapjen e institucionit arsimor privat, parauniversitar, të arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë “*Woodrow Wilson International*”, ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhën angleze dhe forma e arsimit do të jetë arsim me kohë të plotë.

2. Institucioni arsimor privat, parauniversitar, i arsimit bazë dhe i arsimit të mesëm të lartë, “*Woodrow Wilson International*”, duhet të vendosë në dispozicion të institucionit arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar në zbatim të akteve rregullatore në fuqi.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar, Durrës, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë dhe institucioni arsimor privat, parauniversitar, i arsimit bazë dhe i arsimit të mesëm të lartë, “*Woodrow Wilson International*” për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama